



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Për kandidatët të cilët do të regjistrohen për provimet për AL dhe KM të sezoneve përgjatë vitit 2019 duhet të plotësohen kriteret në vijim:

I. KANDIDATËT PËR AUDITUES LIGJORË (AL) duhet të paraqesin:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale, ku të listohen dokumentat e paraqitura;
2. Fotokopje të Kartës së identitetit;
3. Kopje të certifikatës të kryerjes ose vendimit të përjashtimit nga praktika profesionale të lëshuar nga IEKA ose Bordi i Mbikëqyrjes Publike; (Në rastet kur kandidati është në proces të vendimmarrjes së përjashtimit, ky vërtetim mund të dorëzohet deri në 3 ditë para provimit të parë);
4. Për personat që nuk plotësojnë pikën 3 më sipër, vërtetim të lëshuar nga IEKA për kalimin me sukses të testeve të parashikuara në programin e përgatitjes profesionale sipas nenit 18, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, si dhe kryerjen e gjysmës së praktikës profesionale;
5. Personat që kanë marrë titullin ACCA ose CPA në një shtet tjetër, pas dorëzimit të kopjes së diplomës/certifikatës së titullit të noterizuar me vulë apostile dhe letres për gjendjen e anetaresise, duhet të jene të vlerësuar sipas kuadrit ligjor rregullator të zbatueshem, për përjashtimin nga dhenia disa provimeve profesionale.
6. Fotokopje të noterizuar të diplomës ku të ketë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë në nivelin “Master”, ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar ose ekuivalente me këtë nivel për çdonjerën nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to;
7. Dëshmi të gjendjes personale gjyqësore (dëshmi penaliteti) të 3 muajve të fundit (në mungesë të saj vetëdeklarim dhe dorëzimin e dëshmisë para marrjes së dëshmisë për kalimin e provimeve). Në rast mosdorëzimi të dëshmisë së penalitetit, në momentin e marrjes së dëshmisë që tregon përfundimin me sukses të provimeve përkatëse të organizuara nga KPAP, atëherë kjo dëshmi nuk mund të lëshohet;
8. Dokument bankar për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në shumën 5.000 lekë

II. KANDIDATËT PËR KONTABILIST TË MIRATUAR (KM) duhet të paraqesin:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale, ku të listohen dokumentat e paraqitura;
2. Fotokopje të Kartës së identitetit;
3. Fotokopje të noterizuar të diplomës ku të ketë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë në nivelin “Master”, ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar ose ekuivalente me këtë nivel për çdonjerën nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to;
4. Vërtetim se ka të paktën tre vite përvojë profesionale në fushën e kontabilitetit, të financës, kontrollit financiar dhe në fusha të ngjashme. Si vërtetim mund të shërbejnë fotokopje e noterizuar e librezës së punës, ose vërtetim nga sigurimet shoqërorë për gjendjen e sigurimit shoqëror e shëndetësor, ose vërtetime të tjera të cilat provojnë kriterin ligjor të përvojës në punë;
5. Vërtetime ose çertifikata, ose fotokopje të noterizuara të tyre, që tregojnë se kandidati ka kryer kursin e kualifikimit në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të organizuar ose të monitoruar nga organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar, në të cilën individi dëshiron të anëtarësohet. Këto dokumente, për efekt regjistrimi janë të vlefshme nga momenti i lëshimit, me përjashtim të rastit kur kanë ndodhur ndryshime thelbësore të këtyre standardeve, sipas legjislacionit në fuqi. (Në rastet kur kandidati është në proces të kryerjes së këtij kualifikimi, ky vërtetim mund të dorëzohet deri në 5 ditë para provimit të parë);
6. Dëshmi të gjendjes personale gjyqësore (dëshmi penaliteti) të 3 muajve të fundit (në mungesë të saj vetëdeklarim dhe dorëzimin e dëshmisë para marrjes së dëshmisë për kalimin e provimeve). Në rast mosdorëzimi të dëshmisë së penalitetit, në momentin e marrje së dëshmisë që = tregon përfundimin me sukses të organizuara nga KPAP, atëherë kjo dëshmi nuk mund të lëshohet;
7. Dokument bankar për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në shumën 5.000 lekë.

III. KANDIDATËT QË KANË DORËZUAR DOKUMENTACION NË SEZONET E KALUARA DHE NUK JANË SHPALLUR FITUES PËR TË MARRË PJESË NË PROVIME NË KËTË SEZON OSE JANË TË MBARTUR NGA SEZONI I 2018, duhet të paraqesin:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale;
2. Kopje të ID,
3. Dëshmi të gjendjes personale gjyqësore (dëshmi penaliteti) të 3 muajve të fundit (në mungesë të saj, vetëdeklarim dhe dorëzimin e dëshmisë para marrjes së dëshmisë për kalimin e provimeve). Në rast mosdorëzimi të dëshmisë së penaltetit, në momentin e marrjes së dëshmisë që tregon tregon përfundimin me sukses të provimeve përkatëse të organizuara nga KPAP, atëherë kjo dëshmi nuk mund të lëshohet;
4. Dokument bankar për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në shumën 5.000 lekë

SHËNIM:

- a. Përveç dokumentave të dorëzuar sipas pikave përkatëse më sipër, kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të kërkesës ku janë të listuara të gjitha dokumentat e dorëzuar, si dhe dokumentin bankar që vërteton kryerjen e pagesës pranë strukturës mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (Rr. "Ismail Qemali", Pallati 5, Kati i II-të, Ap. 8, Tiranë);
- b. Afati i kryerjes së pagesës për secilin provim do të jetë deri 3 ditë përpara se kandidatët të hyjnë në provimin përkatës. Dokumenti bankar që vërteton kryerjen e pagesës, dorëzohet në kopje fizike ose elektronike (të skanuar) pranë strukturës mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (info@bmp.al);
- c. Kërkesat për provimet e aftësisë profesionale për kandidatët për AL dhe KM, për provimet e sezonit 2019 do të pranohen në sekretarinë teknike pranë organizatës profesionale, IEKA, në orën 15:00 – 19:00;
- d. Periudha e dorëzimit të dokumentave së bashku me pagesën e regjistrimit do të jetë nga data 1-15 Mars 2019;
- e. Të gjithë kandidatët për AL dhe KM kanë të drejtën të aplikojnë për t'u regjistruar në secilin prej tre provimeve të para, pavarësisht rezultatit të provimit paraardhës. Gjithashtu, kandidatët për AL nëse kanë mbyllur me sukses provimet e mësipërme kanë të drejtën të futen në secilin nga provimet pasardhëse;
- f. Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar shpallet në datën 20 Mars 2019;

Lista e kandidatëve do të publikohet sipas kodeve ku do të shënohet viti përkatës/numri i regjistrimit në Sekretarinë Teknike (Shembull: 2019/xxx).

PAGESA DO TË BËHET NË BANKËN KOMBËTARE TREGTARE BKT

Emërtimi: Bordi i Mbikëqyrjes Publike

Nr.i llogarisë: 434003100

IBAN: AL4520511344003100CLOTCLALLI

Përshkrimi: Tarifë regjistrimi në provimet AL/KM

Shuma: 5.000 lekë

Përshkrimi: Tarifë për provimin për KM [Emërtimi i provimit]

Shuma: 15.000 lekë (për secilin provim)

Përshkrimi: Tarifë për provimin për AL [Emërtimi i provimit]

Shuma: 20.000 lekë (për secilin provim)

Shënim: Tarifat e regjistrimit të arkëtuara janë të pakthyeshme. Kandidatëve që kanë kryer pagesat për secilin provim dhe për arsye të ndryshme nuk janë paraqitur në testim, pagesa i njihet vetëm për sezonin e menjëhershëm pasardhës.